



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300774/5

Tiranë __/__/2023

Lënda : *Rekomandim për analizimin e shkeljeve ligjore të kryera gjatë procedurës administrative të ndëshkimit të shtetasit E.S.*

POLICISË BASHKIAKE

Tiranë

BASHKISË TIRANË

Komisionit të Apelimit

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi E.S., banor në Rrugën "Sitki Çiço", Tiranë. Ankuesi shkruan se është zotërues i një automjeti tip Mercedes-Benz, me targë TR 8218 P. Në datën 04.09.2023, e ka parkuar këtë mjet pranë pallatit, në një hapësirë publike, ku nuk ka asnjë sinjalistikë ndaluese. Rreth orës 22:00, të kësaj date, kur ka dashur të lëviz me automjetin, për arsye të një emergjence, ka konstatuar se ndaj tij ishte vendosur një gjobë në shumën 5000 (pesëmijë) lekë si dhe në rrotën e pasme të automjetit ishte vendosur një bllokues. Arsyeja e kësaj mase sipas procesverbalit mbi kundërvajtjen administrative me nr. serial 0103840, të nënshkruar nga punonjësit e Policisë Bashkiake Bilal Hyka dhe Endri Muça, është "zënia e hapësirës publike me trekëndësh metalik".

Gjithashtu ankuesi shkruan se masa administrative gjobë e vendosur ndaj tij, si dhe masa plotësuese e bllokimit të rrotës së automjetit janë krejtësisht abuzive, pasi në këtë hapësirë publike nuk ka të vendosur asnjë trekëndësh metalik dhe asnjë tabelë ndaluese. Por edhe nëse do të kishte trekëndësh metalik në vendin ku ai parkoi automjetin, kjo nuk provon se personi që ka parkuar në këtë hapësirë publike, të jetë i njëjti me atë që ka

vendosur trekëndëshin, i cili mund të jetë lënë i palosur kur personi që e ka vendosur largohet dhe dikush tjetër e gjen hapësirën publike të lirë dhe parkon. Në këto raste duhet sanksionuar personi përgjegjës dhe jo padrejtësisht dikush tjetër, sikurse ndodhi me atë.

Sipas ankuesit, në fakt, ai ka vënë re se në hapësirën publike ku është sanksionuar dhe në disa hapësira të tjera përreth lagjes së tij, janë hapur vrima rrafsh me asfaltin, ku personi/personat që i kanë zaptuar hapësirat, pasi largohen me automjetet e tyre, vendosin një shufër hekuri, të cilën e fiksojnë me dryn, në mënyrë që atë vend të mos ua zënë persona të tjerë dhe ta kenë të siguar parkingun, pasi gjetja e hapësirave për parkim është kthyer në një problem në këtë zonë. Por çuditërisht, punonjësit e Policisë Bashkiake “nuk i vënë re” këto shufra metalike dhe sanksionojnë padrejtësisht qytetarët për të raportuar se “*u gjet dhe u ndëshkua kundërvajtësi*”.

Përveç sa më sipër, ankuesi shkruan se në rastin e tij, punonjësit e Policisë Bashkiake kanë plotësuar fakte të rreme në procesverbal duke e sanksionuar në mënyrë abuzive. Në hapësirën publike që kanë referuar këta punonjës nuk ka qenë vendosur trekëndësh metalik. Ai nuk ka vendosur trekëndësh metalik në asnjë hapësirë publike të Bashkisë Tiranë dhe nuk është as personi që ka hapur vrimat në asfalt e vendosur shufra metalike.

Ndodhur në këto rrethana, ankuesi kërkon që institucioni i Avokatit të Popullit të marrë në shqyrtim ankesën e tij dhe të mbajë qëndrim ligjor mbi veprimet e paligjshme të punonjësve përkatës të Policisë Bashkiake.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: “*Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij*”, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, gërma “b” të ku parashikohet se: “*Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*”, në nenin 20 ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror*”, si dhe në paragrafin e fundit të nenit 19 ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme*”, ju kërkuam një informacion lidhur me pyetjet e mëposhtme:

1. Cila është baza ligjore e ndëshkimit të shtetasit E.S. me masat administrative gjobë në masën 5000 lekë dhe masës plotësuese të vendosjes së pajisjes bllokuese në rrotën e automjetit?

2. Cila është data e saktë e konstatimit të kësaj shkeljeje?

3. Çfarë provash të tjera, përveç procesverbalit të konstatimit të shkeljes, kanë administruar punonjësit e Policisë Bashkiake Bilal Hyka dhe Endri Muça për të provuar faktin e zënies së hapësirës publike me trekëndësh metalik nga shtetasi E.S., si nëpërmjet pajisjeve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, sikurse parashikohet në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurës Administrative?

4. A kanë dalë aktet nënligjore për karakteristikat dhe mënyrën e përdorimit të pajisjes bllokuese të rrotave të automjeteve nga punonjësit e policisë?

5. Cili janë arsyeja dhe qëllimi i vendosjes së pajisjes bllokuese në rrotën e automjetit të shtetasit E.S., ndërkohë që aktet normative që rregullojnë fushën e qarkullimit rrugor parashikojnë vendosjen e gjobave në mungesë të drejtuesve të mjeteve?

Në vijim të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 32556/1 prot., datë 04.10.2023, na informuat se në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 156, datë 21.12.2018, shërbimet e Policisë Bashkiake kontrollojnë territorin e Bashkisë Tiranë për mos lejimin e zënies së hapësirave publike. Në disa zona janë konstatuar zënie të vendparkimeve publike me mjete rrethore dhe/ose instalacione metalike, të cilat bëjnë të mundur përvetësimin e hapësirës publike. Konkretisht në kryqëzimin e rrugës “Martin Camaj” me Blv. “Zhan D’Ark” janë konstatuar zënie të hapësirave publike dhe është ndërhyrë në bashkëpunim me punonjësit e ndërmarrjeve të bashkisë për të liruar këto hapësira publike të zëna.

Në datën 04.09.2023, në orën 20:24, hapësira e liruar ishte zënë përsëri me konstruksione metalike të lëvizshme dhe të personalizuar me një dryn, që nuk bënte të mundur heqjen/lëvizjen e këtij konstruksioni. Në orën 20:24 është konstatuar mjeti tip “Mercedes Benz” me targë TR 8212 P, i parkuar në këtë hapësirë, i pa pajisur me autorizim nga struktura përkatëse e Bashkisë.

Për sa më sipër, punonjësit e Policisë Bashkiake kanë krijuar bindjen se drejtuesi i mjetit me targë TR 8212 P, është përgjegjës për zaptimin e kësaj hapësire publike (Pasi konstruksioni metalik ka qenë i mbyllur me dryn) dhe ndaj mjetit është marrë masë administrative, si dhe është përdorur masë shtrënguese për pagesën e gjobës me bllokues gome për “Zënie të hapësirës publike me trekëndësh”, bazuar në VKB nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve që vendosen për to në territorin e Bashkisë Tiranë, neni 7, pika 1.

Në datën 05.09.2023, ora 23:30, gjatë rikontrollit në kryqëzimin e rrugës “Martin Camaj” me Blv. “Zhan D’Ark” është konstatuar se bllokuesi i gomës, i cili ishte vendosur në mjetin tip “Mercedes Benz” me targë TR 8212 P ishte dëmtuar dhe mjeti ishte larguar.

Gjithashtu u informuam se punonjësit e Policisë Bashkiake janë paraqitur pranë Komisarariatit të Policisë nr. 4 Tiranë dhe kanë bërë kallëzim për veprën penale “Dëmtimi i pronës”, pasi bllokuesi i rrotës është pronë e Bashkisë Tiranë.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese, verifikimi në vend i rastit në fjalë dhe përgjigja e dërguar nga ana juaj konstatojmë se:

Së pari, në përgjigjen tuaj të cituar më sipër nuk na keni informuar për të gjitha pyetjet e parashtruara në kërkesën tonë. Konkretisht, nuk na keni dërguar informacion se çfarë provash të tjera, përveç procesverbalit të konstatimit të shkeljes, kanë administruar punonjësit e Policisë Bashkiake Bilal Hyka dhe Endri Muça për të provuar faktin e zënies së hapësirës publike me trekëndësh metalik nga shtetasi E.S., si nëpërmjet pajisjeve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, sikurse parashikohet në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurës Administrative. Po ashtu nuk na keni informuar lidhur me miratimin ose jo të akteve nënligjore për karakteristikat dhe mënyrën e përdorimit të pajisjes bllokuese të rrotave të automjeteve nga punonjësit e policisë.

Së dyti, referuar përgjigjes tuaj rezulton se në kryqëzimin e rrugës “Martin Camaj” me Blv. “Zhan D’Ark” janë konstatuar zënie të hapësirave publike dhe është ndërhyrë në bashkëpunim me punonjësit e ndërmarrjeve të bashkisë për të liruar këto hapësira publike të zëna.

Në vijim, ju shpreheni se në datën 04.09.2023, në orën 20:24, hapësira e liruar ishte zënë përsëri me konstruksione metalike të lëvizshme dhe të personalizuar me një dryn, që nuk bënte të mundur heqjen/lëvizjen e këtij konstruksioni. Në orën 20:24 është konstatuar mjete tip “Mercedes Benz” me targë TR 8212 P, i parkuar në këtë hapësirë, i pa pajisur me autorizim nga struktura përkatëse e Bashkisë.

Pra, rezulton se në datën 04.09.2023 dhe orën 20:24, hapësira publike e liruar ishte zënë përsëri me konstruksione metalike të lëvizshme dhe të personalizuar me një dryn, që nuk bënte të mundur heqjen/lëvizjen e këtij konstruksioni. Nëse kjo hapërisë do të ishte zënë, sikurse shpreheni ju në përgjigje, si është e mundur që aty të parkohet mjete tip “Mercedes Benz” me targë TR 8212 P dhe aq më tepër që ky veprim ka ndodhur në të njëjtën kohë (datë dhe orë). Nëqoftëse do të kishte ndodhur vërtet kështu, atëherë shtetasi E.S. do të ishte kapur në kushtet e flagrancës nga punonjësit e Policisë Bashkiake, duke hapur pajisjen/konstruksionin metalik dhe parkuar mjetin e tij, por në fakt kjo nuk ka ndodhur.

Nga verifikimi i bërë në vend nga ana jonë rezulton se në vendin ku ishte parkuar mjete i ankuesit nuk kishte trekëndësh metalik, sikurse pasqyrohet në procesverbalin mbi kundërvajtjen administrative, por një vrimë e hapur në beton në të cilën ishte montuar një tub metalik dhe salduar një unazë metalike. Ky fakt provon se konstruksioni metalik i vendosur nga persona, që ende nuk janë identifikuar nga ana juaj, nuk është hequr nga

punonjësit e Policisë Bashkiake dhe ata të ndërmarrjeve të Bashkisë sikurse referoni në përgjigjen tuaj.

Së treti, në përgjigjen tuaj na informoni se është konstatuar mjete tip “Mercedes Benz” me targë TR 8212 P, i parkuar në këtë hapësirë, i pa pajisur me autorizim nga struktura përkatëse e Bashkisë. Ky justifikim nuk qëndron sepse nga ana jonë u konstatua se në hapësirën publike ku kishte parkuar ankuesi mjetin e tij nuk ka tabelë ndaluese për parkim mjetesesh apo tabelë treguese “Vetëm për rezidentë”. Për rrjedhojë, për të parkuar mjetin në këtë vend/hapësirë publike nuk është e nevojshme pajisja me autorizim nga struktura përkatëse e Bashkisë Tiranë, sepse kjo hapësirë nuk është dedikuar vetëm për rezidentët e zonës/Njësisë Administrative.

Së katërti, zënia e kësaj hapësire nëpërmjet parkimit të mjetit nga ankuesi E.S. nuk do të thotë apo provon faktin se ai është përgjegjës për zaptimin e kësaj hapësire publike, sikurse parashtroi në përgjigjen tuaj. Bindjen se ankuesi është përgjegjës për zaptimin e kësaj hapësire publike punonjësit e Policisë Bashkike duhet ta krijojnë vetëm pasi të konstatojnë në flagrancë që ai po vendoste konstrukcionin metalik të lëvizshëm, po hiqte apo po vendoste shufrën e hekurit në vrimën e hapur apo trekëndëshin ose po hapte/mbyllte drynin e këtij konstrukcioni. Për të provuar këtë fakt, do të ishte korrekte që punonjësit e Policisë Bashkiake ta shoqëronin me prova të tjera nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike, sikurse parashikohet në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurës Administrative¹.

Pra, në rastin konkret nga punonjësit e Policisë Bashkiake nuk është administruar asnjë provë, për të vërtetuar arsyen e masës administrative ndaj ankuesit E.S., se është përgjegjës për zaptimin e kësaj hapësire publike. Në këto kushte, akti i përpiluar nga këta punonjës (procesverbali mbi konstatimin e kundërvajtjes) bie në kundërshtim me nenin 81 “Vlerësimi i provave” të K.Pr.A., i cili parashikon se: *“Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”*.

Referuar kësaj dispozite rezulton që struktura vendimmarrëse e procesit administrativ nuk ka mundur/arritur të administrojë edhe një provë të vetme, ndonëse kjo dispozite kërkon më shumë se një provë kur përcakton *“të gjitha provave së bashku”* për të vërtetuar shkeljen e pretenduar ndaj ankuesit. Mungesa e këtyre provave për të vërtetuar shkeljen administrative të atribuar shtetasit E.S., nga punonjësit e Policisë Bashkiake,

¹ Neni 80 i K.Pr.A. “Kuptimi dhe mjetet e kërkimit të proves”, parashikon se:

“1. Me qëllim përcaktimit e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, organi publik mund:

a) të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertët;

b) të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;...”

ndonëse ky organ ka barrën e provës për ta vërtetuar pretendimin e shkeljes administrative, e bën aktin administrativ të nxjerrë ndaj tij të pabazuar në ligj.

Barra e provës për të provuar ligjshmërinë e akteve administrative gjen mbështetje në nenin 82/1 të Kodit të Procedurës Administrative i cili parashikon se: *“1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë,”*, si dhe në nenin 35, pika 1 të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Organi publik ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative dhe të veprimit tjetër administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të ankuesit, si dhe faktet që ai ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë”*.

Së pesti, justifikimi juaj se, bllokuesi i rrotës së mjetit është vendosur nga punonjësit e Policisë Bashkiake si masë shtrënguese me qëllim që ankuesi të bëj pagesën e gjobës, nuk është i bazuar pasi aktet normative në fuqi² të cilat rregullojnë fushën e qarkullimit rrugor parashikojnë vendosjen e gjobave edhe në mungesë të drejtuesve të mjeteve. Këto akte kanë rregulluar edhe mënyrën e pagesës/vjeljen e saj.

Gjithashtu çojmë se masa plotësuese e vendosjes se bllokuesit të rrotës së mjetit të ankuesit nuk është i bazuar në ligj, pasi në dispozitat që do të referojmë më poshtë nuk ndodhemi në asnjërin prej rasteve që mund të vendosej bllokuesi i rrotës si masë plotësuese.

Në Kodin Rrugor është parashikuar masa plotësuese e bllokimit të mjeteve, respektivisht në nenin 157 me titull “Heqja dhe bllokimi i mjeteve”, ku parashikohet se:

“1. Organet dhe strukturat, të përmendura në nenin 12, kanë të drejtë të vendosin për heqjen e mjeteve:

a) në rrugë dhe pjesë të saj, në të cilat me urdhëresë të entit pronar të rrugës, është përcaktuar se pushimi i mjeteve përbën pengesë a rrezik serioz për qarkullimin rrugor dhe kur sinjali i ndalim pushimit jepet nga tabelat e vendosura posaçërisht;

b) në rastet, për të cilat flitet në nenin 155, pika 4 dhe 6, si dhe në nenin 156, pikat 1, 2 dhe 3;

c) në të gjitha rastet e tjera, kur pushimi i mjeteve është i ndaluar dhe përbën pengesë ose rrezik serioz për qarkullimin rrugor;

d) kur mjeti është lënë në vende ku qëndrimi nuk lejohet, sipas urdhëresave të shpallura nga enti pronar i rrugës, për arsye pastrimi ose mirëmbajtjeje të rrugëve dhe pajisjeve të saj.

dh) në të gjitha rastet e përmendura më lart në këtë nen, heqja e mjeteve bëhet vetëm kur ka tabelë sinjalizuese me shenjën përkatëse.

2. Entet pronare të rrugës janë të autorizuar t’u lëshojnë leje subjekteve të veçanta për kryerjen e shërbimit të heqjes së mjeteve, duke përcaktuar mënyrat e veprimit në përputhje me normat rregulluese. Mjetet e caktuara në shërbimin e sipërpërmendur duhet të kenë karakteristikat e përcaktuara nga aktet në zbatim të këtij Kodi.

² Neni 199 i Kodit Rrugor

3. Përveç heqjes së mjetit, lejohet edhe bllokimi i mjetit nëpërmjet zhvendosjes së tij dhe përdorimit në rrotat të një pajisjeje të veçantë me çelës, pa pasur nevojë për ruajtje. Karakteristikat dhe mënyra e përdorimit të kësaj pajisjeje përcaktohen në aktet në zbatim. Zhbllokimi i mjetit bëhet vetëm mbasi është kryer pagesa e gjobës në vend, sipas nenit 155 pika 8, nenit 156 pika 6 dhe nenit 200 të këtij Kodi. Përdorimi i kësaj pajisjeje nuk lejohet kur mjeti në pozicion të parregullt përbën pengesë ose rrezik për qarkullimin.

4. Heqja dhe bllokimi i mjeteve përbëjnë një masë administrative plotësuese ndaj masës administrative me gjobë që është parashikuar për shkeljet e treguara në pikën 1. ...”

Në nenin 155 “Ndalimi, qëndrimi dhe pushimi i mjeteve”, parashikohet se:

“1. Për zbatimin e këtyre normave:

a) me “ndalim” kuptohet ndërprerja e lëvizjes së mjetit për shkak të nevojave të qarkullimit;

b) me “qëndrim” kuptohet pezullimi i përkohshëm i lëvizjes edhe në zona ku nuk lejohet qëndrimi për të lejuar hipjen ose zbritjen e njerëzve, si dhe për nevoja të tjera me kohëzgjatje të vogël. Gjatë qëndrimit, që sidoqoftë nuk duhet të krijojë pengesë për qarkullimin, drejtuesi i mjetit duhet të jetë i pranishëm dhe i gatshëm për të rifilluar lëvizjen;

c) me “pushim” kuptohet ndërprerja e lëvizjes së mjetit e zgjatur në kohë me mundësi largimi të drejtuesit të mjetit;

d) me “qëndrim emergjencë” kuptohet ndërprerja e lëvizjes kur mjeti është i papërdorshëm, për shkak avarie ose duhet të ndalojë për shkak të gjendjes së keqe fizike të drejtuesit të mjetit a të një pasagjeri.

2. Përveç sinjalizimeve të ndryshme, si dhe në rastet e parashikuara në pikën 4, në rast qëndrimi ose pushimi mjeti duhet të vendoset sa më afër që të jetë e mundur me kufirin e djathtë të karrexhatës, paralelisht me të dhe sipas sensit të lëvizjes. Kur nuk ekziston trotuar i ngritur, duhet të lihet një hapësirë e mjaftueshme për kalimin e këmbësorëve, sidoqoftë jo më e vogël se një metër.

3. Jashtë qendrave të banuara mjetet në qëndrim ose në pushim duhet të vendosen jashtë karrexhatës, por jo në pistat për mjete me pedalas në bankina, përveç rasteve kur është sinjalizuar posaçërisht. Në rast pamundësie, ndalimi ose qëndrimi duhet të kryhet sa më afër që të jetë e mundur me kufirin e djathtë të karrexhatës, paralelisht me të dhe sipas sensit të lëvizjes. Në karrexhatat e rrugëve me përparësi pushimi është i ndaluar.

4. Në rrugët urbane me një sens lëvizjeje pushimi lejohet edhe përgjatë kufirit të majtë të karrexhatës, me kusht që të mbetet hapësirë e mjaftueshme për kalimin e të paktën të një rreshti mjetesh dhe sidoqoftë jo më i vogël se 3 m i gjerë, duke marrë parasysh edhe një qëndrim të mundshëm në krahun e djathtë.

5. Në zonat e pushimit për nevoja të parashikuara mjetet duhet të vendosen në mënyrën e sinjalizuar; përjashtim bëjnë mjetet autoveturë, gjatësia e të cilave nuk e kalon kuadratin e sinjalizuar për parkim të entit pronar të rrugëve.

6. Në zonat ku pushimi lejohet për një kohë të kufizuar, drejtuesi i mjetit është i detyruar të sinjalizojë, në mënyrë plotësisht të dukshme, orarin kur ka filluar pushimi. Aty ku ka sistem kontrolli të kohëzgjatjes së pushimit, është i detyrueshëm përdorimi i tij.

7. Është e ndaluar për cilindo të hapë dyert e një mjeti, të zbresë nga ai, aq më tepër të lërë të hapura dyert, pa qenë i siguruar paraprakisht që ky veprim nuk përbën rrezik ose pengesë për përdoruesit e tjerë të rrugës.

8. Kushdo që shkel përcaktimet e këtij neni tre herë brenda një viti, si dhe kushdo që parkon në mënyrë abuzive në vendet e përcaktuara në hapësirat e rezervuara për

personat me aftësi të kufizuar ose parkon në trotuar, përveç masës administrative me gjobë, i hiqen edhe pikë nga leja e drejtimit.

Ndërsa nënin 156 të këtij Kodi me titull “Ndalimi i qëndrimit dhe pushimit të mjeteve”, parashikohet se:

“1. Qëndrimi dhe pushimi nuk lejohen:

- a) në afërsi ose përgjatë kalimeve në nivel dhe mbi binarët e linjave hekurudhore ose të tramvajit apo aq pranë tyre sa të pengohet lëvizja;
- b) në tunele, në nënkalime, nën mbikalimet, nën harqet dhe portat, përveçse kur është sinjalizuar ndryshe;
- c) në kurrize rrugë dhe kthesa, jashtë qendrave të banuara dhe në rrugët urbane të kategorisë së parë, edhe në afërsi të tyre;
- d) në sinjalet rrugore vertikale dhe semaforike dhe 30 m në afërsi të tyre, kur pengojnë fushëpamjen, si dhe në sinjalet horizontale të përzgjedhjes paraprake dhe gjatë korsive udhëzuese;
- e) jashtë qendrave të banuara, në zonat e kryqëzimeve dhe në afërsi të tyre;
- f) në qendrat e banuara në zonat e kryqëzimeve dhe në afërsi të tyre në më pak se 5 m nga zgjatimi i buzës më të afërme të karrexhatës transversale, përveç rasteve kur sinjalizohet ndryshe;
- g) në rrugëkalimet dhe vendkalimet për këmbësorë, në korsitë për mjete me pedal dhe mjete të ngjashme me to, si dhe në daljet e tyre;
- h) në trotuare, përveç rasteve kur sinjalizohet ndryshe.

2. Pushimi i një mjeti në karrexhatë ndalohet:

- a) në rrugë kalimet e mjeteve;
- b) kudo ku ndalohet vendosja pranë një mjeti tjetër në pushim të rregullt, ose zhvendosja e mjetit në pushim;
- c) në rresht të dytë, përveç rasteve kur kemi të bëjmë me 2 mjete me pedal, 2 çiklomotorë me dy rrota ose 2 motorë me dy rrota;
- d) në hapësirat e rezervuara për stacionimin dhe qëndrimin e autobusëve, trolejbusëve dhe të mjeteve që qarkullojnë mbi shina dhe, aty ku ato nuk janë të kufizuara me shenja, në një largësi jo më të vogël se 15 m nga sinjali i stacionit, si dhe në hapësirat e rezervuara për stacionimin e mjeteve të shërbimit taksi;
- e) në zonat e destinuara për mjetet e shkarkimit të mallrave në orët e caktuara;
- f) në bankina, përveç rasteve kur sinjalizohet ndryshe;
- g) në hapësirat e rezervuara për qëndrimin ose pushimin e mjeteve për invalidë sipas nenit 186 dhe në rrafshet e pjerrëta ose bashkimet e rakorduara ndërmjet trotuarëve, rampave a korridoreve të tranzitimit me karrexhatën që përdoret nga këto mjete;
- h) në korsi ose karrexhata të rezervuara për mjete publike;
- i) në zonat urbane për këmbësorë;
- j) në zonat me trafik të kufizuar për mjetet e paautorizuara;
- k) në hapësirat e caktuara për impiante ose pajisje të destinuara për shërbime të emergjencës ose të higjienës publike të treguara me sinjalet përkatëse;
- l) përpara kasave të plehrave urbane ose mbajtës të ngjashëm;
- m) vetëm gjatë orëve të punës, në dhe pranë pikave të shpërndarjes së karburantit, të vendosura në zonën e rrugës, deri në 5 m përpara dhe pas instalimeve të destinuara për furnizim.

3. Në qendrat e banuara ndalohet pushimi i rimorkiove, kur janë të shkëputura nga mjeti tërheqës, përveç rasteve kur sinjalizohet ndryshe.

4. Gjatë qëndrimit dhe pushimit drejtuesi i mjetit duhet të marrë masat e nevojshme për të mënjeluar aksidentet dhe për të mos lejuar përdorimin e mjetit pa pëlqimin e tij.

6. *Cilido, që shkel dispozitat e këtij neni, ndëshkohet me masë administrative, me gjobë nga një mijë deri në tre mijë lekë”.*

Nga ana tjetër, vlerësojmë se ky veprim nuk i shërben as qëllimit për lirim e hapësirave publike por ndikon në të kundërtën, duke e zgjatur zaptimin e saj nga kundërvajtësi.

Së gjashti, masa e gjobës 5000 (pesëmijë) lekë e vendosur ankuesit nuk është e bazuar në ligj. Edhe nëse ai do ta kishte kryer kundërvajtjen administrative për zënien e hapësirës publike, referuar nenit 7, pika 4³ të VKB Tiranë nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve që vendosen për to në territorin e Bashkisë Tiranë”, ndaj tij duhet të ishte aplikuar masa “Paralajmërim me shkrim” dhe jo me gjobë sikurse është bërë në fakt.

Në përmbyllje të hetimit tonë administrativ, vlerësuam se akti administrativ, procesverbali mbi kundërvajtjen administrative me nr. serial 0103840, i përpiluar nga punonjësit e Policisë Bashkiake Bilal Hyka dhe Endri Muça, ndaj ankuesit E.S. është akt i paligjshëm në kuptim të parashikimeve të nenit 109 të K.Pr.A⁴.

Ndodhur në këto rrethana, kur akti administrativ në fjalë është i paligjshëm dhe vazhdon të sjellë pasoja duke cenuar të drejtat ligjore të ankuesit, në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ankuesit, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”; në nenin 21/c të këtij ligji, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka

³ “Në rastin kur subjekti kundërvajtës rezulton se është i padënuar administrativisht për shkeljen e konstatuar, atëhere struktura konstatuese vepron duke vendosur fillimisht dënimin e “Paralajmërimin me shkrim”, sipas nenit 15, pika 1, shkronja “a” të këtij vendimi.”

⁴ Paligjshmëria e aktit administrativ

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

shkaktuar shkeljen;” si dhe në nenet 109/b/d/dh (të cilin e kemi cituar më sipër) dhe 113⁵ dhe 117/2⁶ të Kodit të Procedurës Administrative,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme për anulimin e masës administrative me gjobë në masën 5 000 (pesëmijë) lekë të vendosur ndaj drejtuesit të mjetit shtetasit E.S.
2. Analizimin e shkeljeve ligjore të kryera nga punonjësit e Policisë Bashkiake Bilal Hyka dhe Endri Muça gjatë procedurës administrative për ndëshkimin e drejtuesit të mjetit E.S. në datën 04.09.2023, nxjerrjen e përgjegjësive ligjore dhe marrjen e masave disiplinore ndaj tyre.
3. Përgjithësimin e këtij rasti në organin tuaj me qëllim zbatimin me korrektesë të të gjitha akteve normative në fuqi të cilat rregullojnë fushën e qarkullimit rrugor dhe mos përsëritjen në të ardhmen të këtyre shkeljeve.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

Konceptoi: S. Nushi

⁵ Neni 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.

3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

⁶ Neni 117

Afati për anulimin dhe shfuqizimin

1. Shfuqizimi, në rastin e parashikuar në pikën 1, të nenit 116, të këtij Kodi, mund të bëhet në çdo kohë.

2. Në çdo rast tjetër, të ndryshëm nga ai i parashikuar në pikën 1, të këtij neni, anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrative.